



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
TË MBAJTUR MË 24.10.2017

TETOR
2017

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Komisionit për Legjislacion, z. Albulena Haxhiu

Albulena Haxhiu paraqiti para komisionit rendin e ditës dhe pasi konstatoi se i njëjti u miratua fjalën i'a kaloi u.d. të Agjencionit Kosovar për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës znj. Florije Kika, për të paraqitur para komisionit Raportin Vjetor për vitin 2016.

FLORIJE KIKA-ky raport për ne ka një rëndësi të dyfishtë sepse shënon raportin e fundit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe njëkohësisht raportin e parë të punës për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës. Rëndësia e parë ka të bëjë me përmbylljen me sukses të mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës ku kanë përfunduar shqyrtimi i 42.749 kërkesave,ndërsa rëndësia e dytë është fillimi i një misioni të ri që lidhet poashtu me një mandat të ri të agjencisë i themeluar me miratimin e ligjit 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës i cili me datë 3 nëntor 2016 ka hyrë në fuqi.

Themelimi i Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës është rezultat i Marrëveshjes për Kadastër të arritur në Bruksel në vitin 2011 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe ka për mandat krahaskimin dhe zgjedhjen e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale,originale të marra në Kosovë nga autoriteti serb para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale,aktuale në Republikën e Kosovës për pronën private,pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Me themelimin e agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës,Agjencia Kosovare e Pronës ka pushuar së ekzistuari dhe përveç mandatit të ri të dhënë agjencisë i janë bartur të gjitha kompetencat përfshirë buxhetin,obligimet kontraktuale,asetet fizike si dhe përfshirë këtu mandatin e AKP-së lidhur me zbatimin e vendimeve të AKP-së si dhe zbatimin e vendimeve të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore.

Gjatë periudhës së raportimit nuk është mbajtur ndonjë seancë e Komisionit kjo për shkak që ka pas mungesë të emërimit të anëtarëve të komisionit. Edhe pse Agjencia Kosovare e Pronës ka përfunduar gjitha kërkesat, në agjenci janë paraparë disa kërkesa që duhet të kthehen në rishqyrtim, numri i tyre është diku rreth 20 kërkesa mirëpo për shkak të mungesës së emërimit të komisionit asnjëherë gjatë vitit të kaluar nuk është mbajtur ndonjë seancë e komisionit.

Gjatë periudhës raportuese Agjencia ka pranuar 33 ankesa kundër vendimeve të Komisionit dhe të gjitha nga këto janë dërguar në Gjykatën Supreme.

Gjykata Supreme ka vendosur në 152 ankesa ku prej tyre 129 janë refuzuar , ndërsa 29 janë miratuar.

Numri i përgjithshëm i vendimeve të zbatuara nga Komisioni gjatë periudhës raportuese është 2368. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe agjencia ka pranuar 765 kërkesa të reja për zbatim nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave. Prej tyre 214 kërkesa për dhënien e pronës nënadministrim, 155 kërkesa për ri posedim dhe 396 kërkesa për mbyllje të rastit.

Gjatë periudhës së raportimit agjencia ka shpërndarë 645 vendime dhe 173 aktgjykime të Gjykatës Supreme.

Po ashtu në kohën e raportimit 1158 qiramarrës kanë nënshkruar marrëveshjen e qirasë prej të cilave 363 janë për prona bujqësore, 9 për prona komerciale dhe 786 për prona banesore.

Gjatë vitit 2016, 1429 prona të reja janë përfshirë në skemën vullnetare të qirasë prej të cilave 425 prona bujqësore, 14 prona komerciale dhe 990 prona banesore.

Gjatë periudhës së raportimit 20 mijë e 840 mijë euro janë mbledhur nga qiraja. Ndërsa në total shuma e mbledhur është 543 mijë e 638.83 euro.

Gjatë vitit 2016, agjencia ka planifikuar në total 3292 raste të dëbimit, ndërsa prej këtij numri 1125 dëbime fizike janë ekzekutuar nga njësia e dëbimeve.

Në fund të vitit 2016, njësia e dëbimeve ka pasur kërkesa në pritje 640.

Në vitin 2016, në Mitrovicën e veriut janë bërë vetëm tri dëbime fizike, ndërsa janë ekzekutuar 56, ndërsa janë anuluar 535.

Në prokurori janë iniciuar 16 raste për riuzurpim të pronës, ku janë identifikuar 55 raste të strukturave të paligjshme të ndërtuara në prona private. Prej këtyre 55 rasteve 8 është arritur ndërmjetësim në mes të palëve.

Gjatë kësaj periudhe agjencia është përballuar me sfida të shumta, pjesën më të madhe të së cilave i ka kaluar falë angazhimit dhe përkushtimit të vazhdueshëm të stafit profesional që ka.

Mosemërimi i pozitive kyçe drejtuese të agjencisë si drejtorit ekzekutiv, zëvendës drejtorit, pozitive të dy anëtarëve të bordit dhe anëtarëve të Komisionit, qëndrueshmëria financiare, vështirësitë e dëbimeve në pjesën veriore të Mitrovicës, raste të përsëritura të riuzurpimeve, mos realizimi i skemës së kompensimit si dhe vonesa e miratimit të Ligjit për AKKVP-në kanë qenë disa nga sfidat që është ballafaquar agjencia gjatë periudhës raportuese.

KRYETARJA: Faleminderit!

Atëherë së pari më duhet me theksua që si Lëvizje “Vetëvendosje” e kemi kundërshtua raportet e KPA-së në atë kohë dhe në njërën prej mbledhjeve patët raportuar edhe ju për shkak të rolit diskriminues që ka pasur AKP-ja në raport me rastet që i ka shqyrtuar.

Tash po flitet edhe për Agjencinë për Verifikim të Pronës që bazohet apo që është themelua nga një marrëveshje e nënshkruar në Bruksel që sigurisht për neve si Vetëvendosje ka qenë i papranueshëm fakti se si një shtet sovran apo përfaqësuesit e një shteti sovranë pranojnë që të merren kopjet e regjistrit kadastral dhe jo origjinali dhe sigurisht këto kanë qenë arsyet tona sepse e kemi kundërshtuar edhe Agjencinë për Verifikim të Pronës. Madje disa prej neneve të këtij ligji kanë rënë ndesh edhe me kushtetutën, pikërisht duke marrë parasysh të rolit të .. që ka në raport me Agjencinë për Verifikim të Pronës, ku emërohen dy anëtar pas konsultimit me OSBE-në në njërën anë është thanë që ka përfunduar mbikëqyrja e pavarësisë dhe që nuk ka

përfaqësues ndërkombëtarë në institucionet e Republikë, pastaj aty inkuadrohen edhe përfaqësuesi ndërkombëtar.

Tash mbetet i papranueshëm vetë ekzistimi i një agjencioni që për bindjen tonë është një organ para gjyqësorë sepse na kujtohet kur është themelua KPA-ja, është themelua me arsyetimin se është duke i shërbyer shkarkimit të lëndëve gjyqësore. Tash në fakt KPA-ja është shndërrua në Agjencinë për Verifikim të Pronës që ku ja shtua edhe krahasimi i dokumenteve poseduese me të dhënat e dokumenteve kadastrale, kopjeve që i marrin nga Serbia.

Dhe sigurisht duke u nisur prej kësaj ne natyrisht që e kundërshtojmë edhe këtë qasje sepse për ne mbetet e papranueshëm fakti se si asnjëherë institucionet apo përfaqësuesit në negociatat e Brukselit nuk kanë bërë përpjekje që kopjet t'i kemi origjinal, dokumentet t'i kemi në verizionin origjinal ato që Serbia i ka vjedhur nga Republika e Kosovës dhe jo kopjet dhe kjo është e papranueshme për një vend sovran rrjedhimisht edhe për Vetëvendosjen.

Unë do t'ia lë hapësirën edhe anëtarëve të Komisionit që ta kenë fjalën, mirëpo po më intereson edhe pozicioni i juaj jeni ushtruese e detyrës që sa vite.

FLORIE KIKA : Rreth tre vjet e gjysmë.

KRYETARJA: Tre vjet e gjysmë jeni ushtruese e detyrës dhe kjo është në shpërputhje me ligjet në Republikën e Kosovës duke marrë parasysh..

FLORIE KIKA : Mirëpo kjo pozitë duhet të shkoj përmes Kuvendit, kështu që mendoj që barra sigurisht që i takon edhe Kuvendit, juve si anëtar, si deputetë, juve dhe si kryesuese e Komisionit.

Kryetari i Bordit ka dërguar disa shkresa edhe në Kuvend edhe në Qeveri për emërimin e pozitave kyçe, mirëpo asnjëherë nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

KRYETARJA: Unë vetëm e njoftoj që asnjëherë Komisioni për Legjislacion nuk ka pranuar shkresa nga institucioni që ju sot përfaqësoni dhe për bindjen time është e papranueshme që një person të qëndroj ushtruese e detyrës që tri vite pavarësisht që nuk kam asgjë personalisht me ty por me shkeljet e vazhdueshme që po bëhen dhe nuk është rasti i ngjashëm vetëm tek ju por edhe te shumë institucione tjera.

Po e hapi debatin edhe për anëtarë të tjerë të komisioneve. Kush e dëshiron fjalën në lidhje me këtë raport. Arben.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Unë i kam dy pyetje sqaruese.

Në prezantimin e juaj thatë se shumicën e dokumenteve origjinale i ka marrë autoriteti serbë. Çka konsideroni ju autoritet serbë? Pse çka konsiderojmë është komplet diçka tjetër dhe në kohën të cilën i referohemi kanë qenë një regjim pushtues dhe diskriminues i Serbisë dhe i Jugosllavisë në atë kohë dhe nuk mendoj se quhet autoritet serbë në Kosovë.

Dhe e dyta, pse 535 raste në Mitrovicën e Veriut, më duk kështu thatë janë anuluar nga ekzekutivi. Faleminderit!

FLORIJE KIKA: Autoritetet serbe si fjali e cila është përdorur këtu, ne nuk kemi pasur ndonjë arsyetim qëllim të caktuar të cilit ju kemi referua, mirëpo në kuptimin që janë marrë në bazë të një vendimi të atëhershëm të pushtetit të atëhershëm janë marrë këto vendime dhe për atë arsye ju kemi referua dhe periudha '99 ka qenë ai vendimi me të cilin janë marrë të gjitha dokumentet edhe janë largua në Serbi, të paktën këto informacione që i kemi marrë nga Agjencia Kadastrale.

ARBEN GASHI: Një pyetje shtesë? Domethënë ka një vendim formal juridik në bazën e të cilit merren dokumentacionet prej Kosovës, apo veç është marrë fizikisht janë marrë kur janë tërheqë forcat serbe, apo ka vendim me shkrim. Okej. Ish kon mirë me pas qatë vendim Komisioni.

KRYETARJA: Po. tash fjalën e ka zoti Beqa.

FLORIJE KIKA: 550 raste janë anulua për për shkak të vështirësive, unë e ceka edhe më herët që është sfidë shumë e madhe për agjencinë për me veprua sikur për të gjitha institucionet tjera në pjesën veriore. Pavarësisht që ne kemi prezencën e një stafi ndërkombëtarë të cilët na ndihmojnë të bëjmë ekzekutimin edhe të ... atje. Mirëpo në një periudhë, prezenca ndërkombëtare gjatë periudhës së kaluar kanë dhënë dorëheqje dhe nuk e kemi pasur prezencën ndërkombëtare për atë arsye janë anuluar dhe të gjitha këto dëbime.

Ju i dini sfidat të cilat ekzistojnë atje, qarkullimi i automjeteve tona, siguri sikurse të gjitha institucionet tjera që kanë vështirësi.

ARBEN GASHI: Më fal. Autoritetet lokale po flas për policinë. Nuk bëhet fjalë për individë ndërkombëtarë po autoritet lokale Policia e Kosovës a janë bashkëpunues a e kryejnë detyrën e vetë në fakt, nuk ka lidhje a duhet me qenë ata bashkëpunues, e kanë detyrë ligjore me marrë veprime mbi bazën e kërkesës së tuaj. Domethënë a marrin veprime Policia e Kosovës në pjesën veriore, qysh marrin veprime në pjesën tjetër të Kosovës. a janë veprime të njëjta, a janë procedura të njëjta dhe pse rezultati nuk po është, nuk po shoh rezultat përderisa janë 535 vendime të anuluar për ekzekutim. Ndërkohë që në pjesën tjetër të Kosovës nuk ka ndonjë gjendje të tillë, domethënë a i kryen detyrat e veta Policia e Kosovës në këto hapësira ku nuk ka ekzekutim ka anulim masiv të vendimeve të marura.

FLORIJE KIKA: Ne kemi marrëveshje të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës në çdo dëbim ata asistojnë agjencinë në realizimin e dëbimeve në të gjitha pjesët e Kosovës edhe në Mitrovicën e veriut.

Ne kemi ekzekutua 56 raste, mirëpo 535 të tjera janë anulua. Shumica prej këtyre kanë qenë për shkak të pagesës, kanë mundur ata palët që të kryejnë pagesat edhe në momentin e fundit, mirëpo kemi pas dhe kemi hasur shpeshherë në vështirësinë në operimin ...

ARBEN GASHI: Me sa kuptova unë, ju thatë tri raste dëbimit, 56 raste rikthimit dhe 535 raste të anuluar. Po i keni tri raste dëbimi, kjo 56.

FLORJE KIKA : Jo, tri raste dëbimi është krye fizik, 56 raste ata vullnetarisht e kanë liruar pronën, 535 raste janë anulua, nëse e kanë bërë pagesën sepse ne kemi raste të ndryshme të dëbimeve, nuk kemi vetëm raste për ripostedim, rastet kur duhet me dhunë mu largua, mirëpo kemi edhe raste kur bëhen dëbimet për shkak të mos pagesës të qirasë. Do të thotë në rastet kur ata në momentin e fundit e kanë bërë pagesën e qirasë këto raste janë anulua për shkak të pagesës së qirasë.

Mirëpo ka pasur edhe raste të cilat kanë qenë më të komplikuar që kanë qenë më vështirë për me mujtë me ekzekutua.

KRYETARJA: Zoti Beqa, fillimisht e ra rend, pastaj zoti Kurteshi.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetare!

Përsëritje për kolegë deputetë,

Për të gjithë të pranishmit,

Për mediat,

Unë do të ndalem në ato që u ndal edhe kryetarja te mandati i juaj ose të ushtrues detyrës sepse kjo është përgjegjësi e institucioneve në këtë rast të Kuvendit edhe ne duhet ta kryejmë punën tonë si Kuvend.

Të njëjtën kohë edhe te themelimi i agjencisë edhe kjo mendoj që duhet të shqyrtohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ... po bisedojmë rreth raportimit të agjencisë.

A është dashtë me qenë kjo agjenci a nuk është dashtë edhe unë mendoj që nuk është dashtë me qenë kjo agjenci në Republikë të Kosovës kur ne funksionojmë si shtet i pavarur dhe sovranë.

Realisht edhe unë desha të ndalem te, ju thatë .. një raport i mirë, i pasqyruar drejtë do të thotë për punën e juaj, për aktivitetin edhe për sfidat që ishin do të thotë edhe njëra prej sfidave ishte edhe bordi apo ekzekutiv emërimi i tyre, miratimi i ligjit, ligji është miratua realisht në këtë periudhë për të cilën po bëjmë fjalë.

Realisht vendimi është shfaq shqetësuese apo nuk e kisha të qartë, i cilës periudhë është vendimi dhe për cilën kohë bëhet fjalë vendimi që i ka marrë Serbia dokumentet .

FLORIJE KIKA: Jo nuk kam ashtu informacione.

HAJDAR BEQA: E po atëherë ju a keni të drejtë me i dhënë dokument tash, në bazë të cilit vendim jepni dokumentet, po folni prapë jo.

FLORIJE KIKA: Jo, ende ne nuk i kemi marrë.

HAJDAR BEQA: Po flitni vetëm për periudhën atëherë.

FLORIJE KIKA: Jo ne nuk kemi marrë asnjë...

HAJDAR BEQA: Duhet me i pas mendoj që agjencia e juaj duhet me i pas për cilën periudhë bëhet fjalë, a bëhet fjalë vendim për kohën e tranzicionit, a bëhet fjalë mas vitit '91, aa bëhet fjalë në vitin '99, a bëhet fjalë në kohën e luftës, është mirë me na dhënë , thanë edhe kolegët paraprak këtë vendim është mirë me e pas edhe ju, nëse thirrni në vendim është mirë mu citu numrin e vendimit edhe kohën kur është marrë vendimi, datën e vendimit.

Edhe ashtu me na informua me këtë vendim, me na dërgua si Komision. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Me theksua, me heq përgjegjësinë e Kuvendit karshi zgjedhjes së drejtorit sepse ligji thotë që, sekretaria ka drejtorin, zëvendësdrejtorin, drejtorin dhe zëvendësdrejtori emërohet nga Kuvendi pas propozimit nga kryeministri me mandatë pesë vjeçar pa të drejtë rizgjedhje.

Domethënë ne nuk kemi pasur asnjëherë propozim nga Qeveria për një drejtor po dorën në zemër nuk e dimë se as ju si agjencion a e keni njoftuar Qeverinë në lidhje me këtë çështje.

Por po ashtu, nuk mundem pa e përmend faktin që marrëveshjet që janë nënshkruar në Bruksel sepse pa dyshim që lidhet edhe me temën që po e diskutojmë, përveç se ka pasur një transparencë në këto marrëveshje edhe sot e kësaj dite po dëshmohej që secila prej atyre marrëveshje bien ndesh me Republikën e Kosovës, madje edhe te anëtarët e Komisionit për Legjislacion po vërehet ndërhyrja arbitrare në sistemin institucional të Republikës së Kosovës dhe sigurisht që pasojat do të jenë afatgjate edhe në raport me temën apo me dokumentet kadastrale të Republikës së Kosovës që Serbia nuk i jep dhe tashmë janë kinëse dakorduar që t'i ketë vetëm kopjet.

Mirëpo, unë po ja kaloj fjalën te zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, kryesuese!

Unë kisha veç pyetje sqaruese, mungon bordi, mungojnë anëtarët e bordit, drejtori, kush punon allahile aty, pyetja ime është. Çka është t'u ngja atëherë.

Edhe pyetja tjetër e përmendët një fjalë koncept, rasti i komplikuar. A bënë pak me na shpjegua çka janë çaste të komplikuar në veri, se komplikuar tash zoti Gashi i bëri 2-3 pyetje, përveç atyre që i kanë pagua vullnetarisht ato obligimet e tyre ka edhe raste të komplikuar, çka duhet me kuptua na me rast të komplikuar. Faleminderit!

FLORIJE KIKA : Faleminderit!

Sa i përket periudhës, në pyetjen e zotit Beqaj, flitet në marrëveshjen e cila është arritur edhe në ligjin është specifikuar e flitet periudha 1999, të gjitha dokumentet që kanë ekzistua në atë kohë, do të thotë janë marrë në vitin 1999 dhe të gjitha dokumentet të përfshirë që kanë qenë deri atëherë, do të thotë përfshinë të gjitha dokumentet.

Ndërsa sa i përket marrëveshjes të cilën e theksuat në raport me stafin ndërkombëtarë.

Është e vërtetë që në fillim kur është përgatit drafti i këtij ligji është cek edhe prezenca ndërkombëtare e cila ka qenë në kundërshtim me ligjet tona, mirëpo tash kjo prezencë

ndërkombëtare është e paraparë në bazë të Ligjit për marrëveshjen në mes të Kosovës dhe Brukselit e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe në këtë marrëveshje janë të specifikuara prezenca e ndërkombëtarëve të tre anëtarëve të komisionit dhe dy anëtarëve të bordit, do të thotë këtu është baza ligjore në të cilën është e përfshirë edhe prezenca ndërkombëtare të këtyre kandidatëve.

Ndërsa sa i përket kush po punon, unë mendoj që meritojmë një vlerësim, punojmë unë si ushtruese e detyrës si menaxhere, kemi pesë komuna regjione të cilat ne funksionojmë, kemi bordin i cili është i përbërë prej tre anëtarëve ndërkombëtarë, kryetari i Bordit është ambasadori i Ambasadës Britanike, një përfaqësues i BE-së, dhe një përfaqësues nga Ambasada Amerikane, ndërsa dy anëtarë vendor nuk janë, ne e kemi pasur një bord i cili e ka përcjell punën tonë, ne kemi prezantua punën tonë para këtij bordi dhe për çdo procedurë ne kemi dhënë një përgjegjësi dhe kemi pas një matje të rezultateve konform planit dhe strategjisë të përgatitura nga ana jonë pas kërkesës së bordit.

Ndërsa Komisioni nuk ka funksionuar edhe pse anëtari vendor i Komisionit ka qenë i emëruar vendor, ndërsa dy anëtare ndërkombëtare nuk kanë qenë të emëruar.

Ndërsa çka po punojmë ne, unë mendoj që po flitet në raport se çfarë kemi ..

Ndërsa edhe ju keni qenë sigurisht të njoftuar sa e gëzua pozitën e kaluar me të gjitha procedurat që kemi pas bashkëpunime shumë të shpeshta me institucionin e juaj.

SAMI KURTESHI: A do të thotë kjo, vërtetë krejt puna e kontrollit vetëm nga bordi ndërkombëtarë.

FLORIJE KIKA: Deri tash, po. Prej 2014 deri tash, në nëntor të vitit 2014 i ka skaduar mandati dy anëtarëve vendor, ndërsa kuorumi ka qenë i përbërë prej tre anëtarëve që ka pas mandat.

Ndërsa në pyetjen tjetër të cilët e cekët në lidhje me rastet e komplikuar. Rastet e komplikuar ju e dini sa është vështirë për të mundur për t'i dhënë me qira pronat, janë raste të komplikuar për shkak që është shumë vështirë me i ofrua qytetarëve me marrë një pronë me qira. Ne shkojmë japim pakon e qirasë, ata nuk janë të interesuar për me e arrit një marrëveshje dhe për me hy në marrëveshje me agjencinë që të lëshohen këto raste.

Atëherë është vështirë në gjithë rajonin e Kosovës të merren pronat me qira e sidomos në pjesën e Mitrovicës veriore është shumë vështirë ...

(Arben Gashi, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARJA: Në fakt gjuha e tyre bazohet në marrëveshje..

Marrëveshjet që janë nënshkrua nga zyrtarët e Qeverisë që tash përgjegjësia po i mbetet zonjës Kika, por që nuk është e drejtë për faktin se secila prej marrëveshjeve që është nënshkrua në Bruksel kësaj gjuhe i referohet duke kontestuar sovranitetin, integritetin territorial dhe sigurisht që pastaj kjo është diskutimi si .. e marrëveshje që janë nënshkrua qoftë nga Hashim Thaçi, qoftë nga Isa Mustafa, qoftë nga Edita Tahiri e të tjerë që kanë qenë pjesë e negociatave në Bruksel.

FLORIJE KIKA : Për informimin e juaj nuk kam qenë pjesë e delegacioni gjatë nënshkrimit të marrëveshjes, e di që ka pasur në bazë të informacioneve që kam pas e di që ka pas shumë kërkesa që të kthehet edhe origjinali, mirëpo është arrit marrëveshja sepse më duk që e cekët më herët që nuk ka pasur insistime apo interesime që të kthehet edhe origjinali...

KRYETARJA: A ke qenë pjesë e negociatave a jo.

FLORIJE KIKA: Jo.

KRYETARJA: Atëherë po ju mungon ta mbani rolin e zëvendësues së Qeverisë, për shkak se unë e di që nuk ka pasur asnjë përpjekje që Kosova ta siguroj origjinalin e dokumenteve kadastale, ka lëshuar pe edhe në këtë drejtim.

FLORIJE KIKA : Ndërsa kam qenë pjesë e negociatave në zbatimin e marrëveshjes, pasi është arrit marrëveshja në zbatim të kësaj marrëveshjes kemi qenë në negociata por jo në arritjen e marrëveshjes.

KRYETARJA: Faleminderit! A ka dikush tjetër, zoti Demaliaj

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryetare!

Flasim për një mekanizëm institucional një agjenci që Kosova ka marrë shumë vonë në dorë në vitin 2014, nuk dua me fol si Aleancë as çka kemi kundërshtua ashka kemi vendos se nuk kemi ardhur me tregua pozicionin tonë politik këtu.

Rezoluta 1244 e OKB-së me të cilën Kosova ka funksionuar prej vitit '99 i ka shpall ligje diskriminuese të gjitha ligjet e periudhës së Millosheviqit.

Aktet, që janë ndërmarrë edhe Serbia e ka marrë dokumentacion, nuk e ka marrë vetëm dokumentacionin katastral ka marrë dokumentacion të mjaftueshëm edhe libra amzë. Ne nuk e dimë qysh ka.. Millosheviqi dhe ne nuk kemi marrë vendime dhe nuk dom me i trajtua vendimet e Millosheviqit sot.

Këtu ka pasur UNMIK, ka pasur EULEX-së, ka pas dreqi e i biri kalua nëpër këto. Këta veprojnë në bazë të qeverive lokale çka ju afrojnë material edhe dokumentacion. Ajo kalon në regjion ku i kanë këta zyrat e veta regjionale.

Mua po më intereson raporti 2016, jo raporti historik, mekanizmi i një njërit që nuk është institucionalisht i veshur me petkun e përgjegjësisë. Këtë njëri që e kemi përpara nuk kemi nevojë me ju drejtua sikur me qenë në gjyq. Neve na intereson shteti a e ka përkrahë, a i ka rastet që e obligon ligji .. është ushtrues detyre, në qoftë se nuk e ka bërë le t'i drejtohet Qeverisë me një shkresë për me e përmbush obligimin institucional për me e përfundua çështjen e vetë, mos me ndejtë atje me vite të tëra.

Të gjithë e thanë po e them edhe unë, nuk është faji i saj pse është ushtruese e detyre, dy qeveritë e kaluara kanë qenë pengesë e madhe në zhvillim po kjo është një mekanizëm tjetër që rështohet edhe marrëveshje ndërkombëtare mbi këtë çështje.

Neve të gjitha ligjet i kemi por të harmonizuara me 'acquis communautaire' po edhe Kushtetutën edhe gjithçka çka derivon prej kësaj i kemi të rregulluar në atë formë.

Ne jemi shtet i ri, po flasim sikur pa kon shtet qe 5 000 vjet edhe pse ka ndodhë kështu.

Unë thash ne rotacionin historik nuk kemi nevojë për mu lëshua më andej. Unë mendoj që ky mekanizëm edhe pse udhëhiqet prej një Bordi ndërkombëtarë ka qenë komplet i udhëhequr prej ndërkombëtarëve të cilet edhe sot e kanë atë bord.

Është mirë të konsultohet brenda hapësirës ligjore që të bëhet funksional edhe kjo zonjë ose dikush tjetër kush do atje për formën e përzgjedhjes në mënyrë institucionale me konkurs apo duhet të emërohen nuk e di, çka se di nuk e flas. Është mirë që ky mekanizëm me pas njërën me përgjegjësi të plotë jo tri vite ushtruese detyrës, ne kur po flasim kështu po i kapim një personi a i kemi nëpër komunat e Kosovës nga 300 vetë me kontratë mbi vepër që është aut gjithë çkafi.

Dhe kur dalim brenda këtij mekanizmi, nuk është mirë për me ju drejtua një njeri...

KRYETARJA: A ke ndonjë pyetje...

SHKUMBIN DEMALIAJ: Pyetja ime është raporti 2016, se nuk jam ardhur me dëgjua histori se po zgjatet takimi, ne jemi deputetë, nuk kam asnjë pyetje.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Në secilën mbledhje të Komisionit zoti Demalijaj në vend të qëndrimeve në lidhje me çështjen po merr rolin e interpretimeve të diskutimeve të anëtarëve të Komisionit për Legjislacion.

Unë besoj që kjo është hera e fund kur ju duhet ta bëni këtë, për fatin se nuk je këtu për me vlerësua diskutimin e anëtarëve të Komisionit por je këtu për me i dhënë qëndrimet e tua në raport me çështjen që po diskutohet.

Unë po flas edhe kur ta përfundoj mandej e merr fjalën.

Të kisha lutë që mos mu lëshua në tema dhe në interpretime të diskutimeve po të keni qëndrime të tuaja për shkak se për bindjen time është një qëndrim goxha e ndryshëm prej kohës sa keni qenë në opozitë sepse ne nuk është hera e parë që po raporton Agjencia Kosovare e Pronës.

Pra, në kohën sa keni qenë në opozitë e keni kundërshtua fushë veprimtarinë, përgjegjësitë që i ka pasur Agjencia Kosovare e Pronës, përfaqësuesit tuaj në Komision për Legjislacion dhe tani këtu po merrni rolin e një avokati apo mbrojtësit të përfaqësueses apo të qeverive dhe po e ... diskutimin e drejtë që po e bëjnë anëtarët e komisionit.

Unë shpresoj që mos me e përsëritë më këtë, për shkak se nuk ta lejoj si kryetare e Komisionit për Legjislacion.

Zoti Sejdiu!

KORAB SEJDIU: Nuk po dua në mikrofon mu regjistrua.

KRYETARJA: .. *(Nuk dëgjohet për transkriptim)*

SHKUMBIN DEMALIAJ: Po dua me fol si deputetë edhe anëtarë i Komisionit edhe pjesë e qeverisë që përfaqësoj mazhorancën.

Nuk jam ardhur këtu për me dëgjua histori, kemi përpara raportin e vitit 2016, dy orë e gjysmë në qoftë se ka nevojë edhe nxjerrim diçka thelbësore, por për mu lëshua në konotacion historik e pse këtë e pse këtë pa e njohtë thelbin, po e shoh se nuk jeni të njoftuar në thelb.

Këtu ka pasur institucione ndërkombëtare, kemi kaluar, i dimë shtyllat qysh kanë qenë të organizuar. Duhet me kon të njoftuar materialin, kur e shoh tanë me cifra, nuk po dua mu lështua pse këto raste, pse këto raste, se është pjesë e ekzekutivit, më vjen keq. Çka ka nevojë kjo për me tregua në Komision, qysh shkojnë Policia me e ekzekutua është detyrë e policisë, obligon ligji. Kjo është me rëndësi, kjo është ajo temë që po e marrë. Për tjetër gjë unë sot po ta lëshoj mbledhjen.

KRYETARJA: Mundesh hiç të mos vish në mbledhje...

(Polemika)

ARBEN GASHI: Të njoftoj për zotin Demaliaj edhe për pranishmit. Pyetja që ka të bëjë me mënyrën e komunikimit me policinë ka të bëjë shumë qartë, me qenë se janë 535 raste të anuluar, interesimi imë është këto shifra janë edhe në raport edhe zonja i prezantoj këtu, interesimi është me pa se sa është efikase Policia e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, pra efikasiteti me kryerjen e detyrave të veta.

Nuk bëhet fjalë këtu për memorandumin mirëkuptimi a donë me kuptua policia a nuk donë me mirëkuptua, e ka detyrë ligjore me u përgjigj në kërkesa që bëhen me zbatim të ligjshmërisë.

Interesimi im ke sa po e zbaton Policia e Kosovës pjesën veriore që nuk është polici e juvja. Unë thjeshtë desha me ditë prej nedvështimit tuaj e mora përgjigjen si duket zoti Demaliaj e ka keqkuptua ose po donë me ngarkua politikisht.

ARBEN GASHI: Prit se nuk je duke e ditë esencën e komunikimit.

Mua po më intereson prej këndvështimit të agjencisë sa përgjigjet Policia e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës në kërkesa që këta i raportojne. Kaq. Mos i merr personalisht se nuk ka të bëjë me Qeverinë kjo punë as nuk ka të bëjë me ju. Ka të bëjë me rritjen e njohurive të mija për

funksionimin e agjencisë dhe efikasitetin në kryerjen e detyrave të veta të Policisë së Kosovës në Mitrovicën e veriut dhe tutje. Kaq e thjeshtë është, zonja më dha përgjigjen, unë jam i kënaqur me përgjigjen. Të falënderoj shumë zonja Kika, besoj se do të kemi edhe raste të tjera ku do të takohemi, shpresoj që puna juaj do të zyrtarizohet ose kushdo që do ta marr detyrën le të jetë fuqi plotë sepse e kuptoj që je në pozitë të pakënaqshme si ushtruese e detyre për tri vjet e gjysmë dhe besoj që javën tjetër kur të raportosh para Komisionit do të raportosh si drejtoresh e plotfuqishme. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Gashi! Zoti Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Përshëndetje, zonja Kika,

Kryetare, kolegë,

Mysafirë të pranishëm,

Ndoshta na fal pak zonja Kika që ndoshta t'i po i merr ato sulmet që ndoshta kem dëshirë me ja bënë njerëzve që na kanë prua në këtë gjendje e tash po mundohemi që atë që po na bartë porosinë me ndëshkua për veprimet e atyre që i kanë krijuar.

Po sidoqoftë është mirë që ndoshta edhe tensionet këtu mu ulën edhe ne me u fokusuar në raportin që e ke prua edhe në çështjet që ndërliken me agjencionin.

Unë me sa e kuptova buxheti i juaj ish diku një milionë e 300 mijë, apo,

FLORIJE KIKA: Po.

Prej të cilave cila pjesë është e buxhetit të Kosovës, se nuk e pata bash të qartë te pasqyra financiare.

FLORIJE KIKA: Gjatë vitit të kaluar, sepse nga viti 2015 ne nuk kemi pasur përkrahje nga ana e donatorëve dhe e gjitha është nga buxheti i Kosovës, një pjesë shumë e vogël e cila nuk kalon përmes buxhetit asistencë e prezencës së stafit ndërkombëtarë e cila është e mbuluar nga ana e vijës tjetër buxhetore dmth jo nga buxheti i Kosoves..

KORAB SEJDIU: Veç domethënë ne po e financojmë një agjencion ku nuk kemi askendë prezentë prej Kosovës, po e mbulojmë faturën po në bord nuk e kemi askend,

FLORIJE KIKA: Në bord nuk kemi askend vendor.

KORAB SEJDIU: Vendore, domethënë tre ndërkombëtarë vendor nuk ka hiq.

FLORIJE KIKA: Po.

KORAB SEJDIU: Okej. Atë veç deshta me e sqarua do të thotë është një lëshim shumë i madh prej anës tonë që po paguajmë për diçka ku ne nuk kemi kurrfarë vendimmarrje edhe nuk mundemi me kërkua llogaridhënie do të thotë qoftë edhe nga ju edhe nga stafi por edhe nga Komisioni.

Çështja tjetër që desha me pyet është çështja e komisionit që është organi vendimmarrës brenda agjencionit.

Që sa mungojnë komisionarët edhe kush është përgjegjës për emërimin e tyre edhe pse do të thotë ka dështua emërimi i tyre deri më tani.

FLORIJE KIKA: Komisionerët mungojnë vetëm anëtarët ndërkombëtarë, anëtari vendor është tre. Dy anëtarë ndërkombëtarë duhet të emërohen nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian dhe që nga marsi i vitit 2015 atyre ju ka skadua mandati dhe nuk janë emëruar do të thotë që nga marsit i vitit 2015.

KORAB SEJDIU: Domethënë që nga marsi i vitit 2015 nuk ka vendimmarrje sa i përket lëndëve në agjencion.

FLORIJE KIKA: Edhe pse të gjitha lëndët janë përfundua mirëpo kemi disa raste që duhet të kthehen në rishqyrtim, është një numër i vogël rreth 20 rasteve, mirëpo që edhe ato....

KORAB SEJDIU: Unë e kuptoj goxha mirë esencën e agjencionit edhe pse jam kundër sepse përveç se është diskriminues nga atyre të tjerëve që nuk i kanë humbur të drejtat pronësore gjatë periudhës së caktuar po flas për mandatin e kaluar jep një far lloj mosbesimi ndaj institucioneve tona sa herë që e krijon një institucion ndaras prej gjykatës domethënë nuk po i beson gjykatës por po ja jep dikujt tjetër.

Po sidoqoftë ajo është çështje që nuk ju përket juve.

Po më lejoni që të pyes sa i përket këtyre rasteve të veriut sepse unë po e shoh që ju ende e keni këtë pjesën e përmbarimit apo i keni njësitë e juaja dhe siç e përmendi edhe kolegu Arbeni do të thotë e merrni edhe policinë me ju ndihmua.

Unë me sa kam informata dhe dijeni une, gjithmonë përmbarimi i vendimeve në veri ka qenë problematik. Po ka pasur një arsytim sepse gjithmonë me sa e di unë drejtori ka qenë ndërkombëtarë dhe vetëm zëvendës drejtori ka qenë vendor. A është e vërtetë. a jeni ju të parët që jeni tash kështu pastër vendor udhëheqës i pjesës ekzekutive apo.

FLORIJE KIKA: Po, unë jam edhe zëvendës, jam e emëruar në pozitën e ushtruese e detyrës të zëvendës drejtorit, mirëpo nuk kemi që nga viti 2014 nuk kemi atë drejtor ekzekutiv sepse ka qenë ndërkombëtarë.

KORAB SEJDIU: Tash a parashihet me pas ende.

FLORIJE KIKA: Jo, tash parashihet që të ketë sekretaria drejtorin dhe zëvendës drejtorin.

KORAB SEJDIU: Vendor.

FLORIJE KIKA: Po, vendor.

KORAB SEJDIU: E tash mua po më intereson me ditë veprimet që i keni marrë në këto tri vite ose tri vite e gjysmë për me përmirësua përmbarimin e lëndëve në veri, se unë po e kuptoj se në të kaluarën keni pasur probleme sepse edhe bordi edhe drejtori gjithmonë ka qenë ai i cili i ka diktua edhe ka hezituara me ndërmarr veprime të cilat kanë qenë politikisht të ndishme.

Çka keni ndërmarr konkretisht për me e tejkalua këtë situatë edhe me vazhdua me përmbarime edhe me i barazua përmbarimet në veri me ato të cilat i ndërmerrni me efikasitet në pjesë të tjera të vendit.

FLORIJE KIKA: Fillimisht në këtë çështje kemi diskutuar edhe në bord, disa herë i kemi adresua edhe në mbledhje të bordit. Natyrisht gjatë gjithë periudhës kemi kërkuar prezencën e ndërkombëtarëve, kemi kërkuar ndihmën e UNDP që të na siguroj me targa të automjeteve për shkak që mundeni me imagjinua kur një veturë e Kosovës duhet t'i heq targat edhe duhet me shkua në Mitrovicën e veriut, atëherë ne kemi arrit marrëveshjen me UNDP ata na sigurojnë targat e UNDP

në mënyrë që ne të paktën me operua në atë pjesë si një institucion qeveritarë.

Kemi kërkuar mbështetje për shkak ...

KRYETARJA: Jam shumë e shqetësuar me qasjen që po merr Kosova domethënë në këtë drejtim.

Në vazhdimësi nga Qeveria është thënë që liria e lëvizjes atje është e garantuar, e papenguar sikurse edhe në gjithë pjesën tjetër të territorit të vendit ashtu edhe në veriun e vendit tonë dhe tani këtu po thuhet që në rastet kur ju shkon atje nevojitet që të shkon me targa të veturave të UNDP për të dukur ndërkombëtarë apo që mos të dukesh shqiptarë. Kjo është përnimend një qasje një deklaratë shqetësuese dhe nuk është përgjegjësia e jotja po është përgjegjësia siç e thash unë përpara të qeveritë e kaluara por edhe ajo aktuale dhe sot po dëshmohet dhe sot po dëshmohet që këto negociata në Serbi as nuk e kanë integruar veriun e vendit tonë dhe as premtime tjera të cilat janë thënë në vazhdimësi.

Po tash përgjigju edhe pyetjes që e tha zoti Sejdiu.

FLORIJE KIKA : Ne kemi kërkuar prezencën edhe të një stafin ndërkombëtarë duke pasur parasysh situatën politike atje që me qenë prezenca e tyre, do të thotë këto kanë qenë disa prej angazhimeve tona që bashkë takime të shumta me Policinë e Kosovës që ta përgatisim dhe kemi fillua që ta bëjmë një plan se si të fillojmë edhe në Mitrovicë të funksionojmë sikurse në pjesën tjetër.

KORAB SEJDIU: Veç për përfundim, nëse më lejohet, se unë po e shoh që e kemi një farë sandviçi këtu ku ju e keni problem ne e kemi problem se ju nuk po keni menaxhment po flas bord edhe neve nuk po na vijnë emrat këtu me i emërua.

A mundemi me bë një sulm të dy anshëm të propozuesit që edhe ju me kërkuar emërimin e bordit edhe funksionalizimin e organit menaxhues që e keni po edhe ne nga ana e jonë me kërkuar zbatimin e legjislacionit në fuqi që të tejkalohen këto situata kur ki bord të një agjencionit të Kosovës pa kosovar e ke një ushtrues detyre tri vjet e gjysmë edhe po mbet pezull. Ndërsa të

drejtat e qytetarëve të këtij vendi po vendosen nga një organ i cili përfundimisht nuk ka nuk jep llogari për një milionë e 300 mijë euro sa kenë edhe për të gjitha ato vendime që po merren në të mirë ose të keq të qytetarëve të këtij vendi edhe pse i besoj plotësisht që procedurat që i kemi janë efikase, të mira e të drejta po si do qoftë janë ata të cilët japin llogari para këtij Kuvendi dhe para vetë qytetarëve të Kosovës.

Unë kisha thënë si propozim që ne t'i drejtohem pra prej dy anëve e ta bëjmë të qartë këtë nevojë urgjente për me funksionalizuar agjencioni pasi veç kemi vendos me bë edhe me dhënë një mandat të caktuar.

FLORIJE KIKA : Veç sa për me plotësua, edhe ju e cekët më herët unë mujë me ja dëshmuja, kemi vetëm gjatë vitit të kaluar mbi 4-5 shkresa të cilat i kemi adresua edhe unë personalisht po edhe nga ana e kryetarit të Bordit edhe Kuvendit, edhe Qeverisë lidhur me emërimin e këtyre pozitave.

Unë mundem me ja u dëshmuja kur i kemi adresua Kuvendit, kryetarit të Kuvendit, kryeministrit të Kosovës, mbi 10 shkresa në qoftë se i referohemi prej periudhës 2014 janë mbi 10 shkresa të cilat unë mujë me jua dëshmuja edhe me i sjell këtu.

KRYETARJA: Zoti Sherifi, fjalën e ke.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetare!

I përshëndes të gjithëve,

Sidomos zonjën Kika, e cila besoj na mirëkupton që jemi në fillim të mandatit dhe tash janë ndër punët e para që po i bëjmë. Prandaj, kemi kaq shumë energji se më vonë ndoshta edhe pak bie intensiteti i këtyre pyetjeve.

Jo desha të pyes, pagesat që tha paguan dikë tjetër, a paguhen edhe të huajt me këtë buxhet apo paguhen vetëm vendorët,

FLORIJE KIKA: Vetëm vendorët,

BILALL SHERIFI: desha të sqaroj se u krijua një përshtypje që po paguhen te tjere unë e morra ashtu desha ta sqaroj. Dmth paguhen njerëz shtetas të Republikës së Kosovës paguhen për punën që e bëjnë, apo.

Që e tërë kjo është pasojë e politikave të gabuara të administratës dhe besoj që s'ka nevojë mu konstatua pikërisht së paku nga shumica këtu që janë është e konstatuar sepse kjo çështje sikur të ishte veriu i Kosovës apo pjesa veriore si Ferizaj si Gjakova nuk do të kishin as për agjencion, nuk do të kishim nevojë as për marrëveshje me policinë memorandum mirëkuptim po zbatoheshin ligjet në fuqi.

Prandaj, i kemi këto mekanizma të ndërmjëmë do t'i quaja që më shumë ngarkohen me çështje specifike ligjore për shkak të politikave, për shkak të situatës politike krijohen këto mekanizma Kam vetëm edhe një pyetje.

Nga raportet e mëhershme besoj që ju jeni më e informuar me këto se unë, unë së paku nuk kam arrit ta lexoj raportin në tërësi se kjo nuk është një lektyrë e shkollës fillore as të mesme me e lexua me një frymë.

Kam një pyetje a ka përparim në këtë drejtim, krahasuar me vitet e mëparshme dhe thjeshtë a ja vlen sipas mendimit të juaj a ja vlen që ky mekanizëm të vazhdoj të veproj, është duke e justifikua tërë këtë investim, tërë këtë buxhet puna apo rezultatet të cilat është duke dhënë. Këto dy pyetje i pata nëse ka mundësi.

KRYETARIJA: Faleminderit, zoti Sherifi, zonja Kika.

FLORIJE KIKA: Faleminderit!

Sa i përket raportit me vite të tëra ky raport në mbledhjen e kaluar të vitit të kaluar njëri prej anëtarëve të Komisionit ma patë parashtruar një pyetje se kur po e lexoj raportin po mendoj që po e lexoj raportin e njëjtë sikur çdo viteve ... Është e vërtetë sepse puna jonë ka të bëjë me shqyrtimin e rasteve dhe flet vetëm për numra, do të thotë krejt çka ne diskutojmë edhe çka mund të përparojmë janë numrat të cilat ne i prezantojmë në këtë raport.

Natyrisht është bërë një punë e suksesshme, mendoj që është bërë një punë shumë e suksesshme, mendoj që institucionet e radha që ka arit në maksimum të kompletoj planin dhe ti arrijë rezultatet në bazë të strategjive dhe planeve të veprimit.

Asnjëherë si agjenci nuk kemi pasur ndonjë raport të Auditorit të Përgjithshëm që ka qenë negativ madje as me rekomandimet më të vogla të mundshme. Të gjitha raportet të cilat janë prezantua edhe të bordit por edhe të gjitha institucioneve tjera kanë qenë shumë pozitive sa i përket punës.

Unë i mbetem borxh edhe stafit profesional në qoftë se nuk i falënderohem për punën që është krye, për angazhimin që është bërë edhe për të gjitha rezultatet të cilat janë arritur.

Sa i përket mandatit të ri sepse nuk e di sa arritët që në fillim të jeni prezentë. Ne si agjenci tashmë jemi transformua me një agjenci të re është Agjencia për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, do të merremi me zbatimin e atyre rasteve të pazbatuara deri tash.

Ndërsa mandati i ri komplet do të jetë i adresuar në një sferë tërësisht të ndryshme nga mandati që ka qenë më herët, do të bëhet verifikimi dhe krahasimi i këtyre dokumenteve dhe mendoj që është shumë e rëndësishme për të drejtat pronësore të qytetarëve që të jenë të definuara dhe të mos kemi problemi.

Të gjithë jemi të informuar për problemet të cilat janë has gjatë gjithë kësaj periudhe sa i përket çështjeve pronës dhe sa kanë qenë të ndërlikuara.

Atëherë mendoj që të kemi një pasqyrë të qartë, të kemi një kadastër të cilit mund të sigurojmë, është shumë e rëndësishme që këto dokumente të kthehen që gjithë qytetarët e Kosovës që kanë probleme dhe kanë mangësi sepse vetëm në qoftë se ju do të ishit ardhur dhe të kishit punua në agjencionin të cilin unë e udhëheqë kishit mund me e vërejt sa shumë janë kërkesat edhe sa

shumë halle kanë qytetarët e Kosovës edhe çdo herë adresohen për me marrë informacione edhe shpesh nuk e dinë as vendin se ku duhet të adresohen të marrin një përgjigje konkrete.

KRYETARJA: Zonja Kika, faleminderit shumë. Është edhe ministri i Drejtësisë duke pritur te dera për të vazhduar me raportim për marrëveshjen me drejtësinë.

Derisa ta përfundojmë raportin. Në qoftë se nuk ka dikush tjetër nga anëtarët e Komisionit. Atëherë unë ju liroj juve. Faleminderit në emër të Komisionit për Legjislacion për raportin për vitin 2016. Shihemi në takime tjera.

Faleminderit, zonja Kika. Faleminderit shumë!

Faleminderit! Kush është për këtë raport?

Pesë janë për, Kush është kundër? Unë jam kundër, Glauku, Sami Kurteshi, 3 janë kundër. A ka abstenime?

BILALL SHERIFI: A ishte pyetja, kush miraton këtë, apo e dërgojmë në seancë. Ju nuk po doni me e qua në seancë, nuk e qomë në seancë as na.

ARBEN GASHI: Ne as nuk e miratojmë, as nuk e rezufojmë, thjeshtë ne e rekomandojmë që shkon për seancë. Pra, ne marrim vendim edhe i rekomandojmë seancës që ta trajtoj këtë raport. Ne nuk mundemi me e kthye, s'mundemi me e ndal, s'mundemi asgjë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Tash e kemi rendin e ditës me Projektligjin për presidentin.

A po vazhdojmë me Projektligjin për presidentin a me raportimin.